

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-274/13

Prishtinë,

14 maj 2014

Në çështjen juridike të:

M.M

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër

Pala përgjegjëse në kërkesë/ ankesë

Nuk ka

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarë: Willem Brower, Kryetar i Kolegjit , Esmë Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/200/2013 (dosja e rastit është regjistruar në AKP me numrin KPA 06531) i datës 18 prill 2013, pas seancës së mbajtur më 14 maj 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. **Refuzohet si e pabazuar ankesa e M.M e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/200/2013 i datës 18 prill 2013 sa i përket rastit të regjistruar në KPA me numrin KPA06531.**
2. **Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/200/2013 i datës 18 prill 2013 sa i përket rastit të regjistruar në KPA me numrin KPA 06531**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 26 janar 2007, M.M ka paraqitur një kërkesë në cilësinë e anëtarit e të bashkësisë familjare të titullarit të pretenduar të së drejtës pronësore- djalit të tije në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) me të cilën ka kërkuar ri posedimin e pronës-lokalit afarist. Ai pretendon se, me Aktgjykimin në bazë të pohimit të Gjykatës Komonale në Ferizaj C.nr.224/90 i dt.17 maj 1990, djali i tije S.M i është pronar i pjesës perëndimore i barakës të tipit montazh që gjendet në rrugën e “Njegoshit “nr.14 në Ferizaj, në sipërfaqe prej 8 m².
2. Ky lokal afarist ka shërbyer për ushtrimin e veprimtarisë afariste. Uzurpimin e kanë bërë personat e panjohur. Kërkesa është regjistruar në AKP me numër KPA06531.
3. Posedimin e këtij objekti komercial e ka humbur për shkak të rrethanave të konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitin 1998/99 ,duke cekur datën e humbjes me 15 qershor 1999.
4. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai e parashtrroi Aktgjykimin në bazë të pohimit të Gjykatës Komonale në Ferizaj C.nr.224/90 i dt.17 maj 1990.Mer këtë aktgjykim konstatohet se pronar se S.M është pronar i ½ të pjesës ideale në anën perëndimore i barakës të tipit montazh që gjendet në rrugën e “Njegoshit “nr.14 në Ferizaj.
5. Sipas Raportit verifikues i AKP-ës i dt.08 mars 2007, aktgjykimi nga paragrafi paraprak që është i plotfuqishëm është verifikuar pozitivisht nga ekipi verifikues i AKP-së.
6. Më 06 prill 2007, zyrtarët e AKP-së shkuan te vendi ku ndodhej objekti afarist-kioska dhe konstatuan që ,ai objekt ishte zaptuar nga O.SH i cili me ç ‘rast ishte prezent dhe nuk ka shprehur gatishmëri për pjesëmarrje në procedurë e as që ka

pretenduar të drejtën e pronës në këtë objekt afarist. Me rastin e notifikimit është konstatuar që ky objekt nuk është i ndërtuar i materialit të karakterit të përhershëm.

7. Më 18 prill 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPCC) me vendimin e tij KPCC/D/C/200/2013, e hodhi poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit. KPCC në arsyetim e vendimit ankimor ka konkluduar se titullari i të drejtës pronësore-kërkuesi i objektit komercial ka përfituar vetëm të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit dhe rrjedhimisht ka qenë i autorizuar për të ndërtuar një objekt i tipit montazh i karakterit të përkohshëm që cilësohet si pronë e luajtshme.
8. Prandaj, prona e kërkuar duhej të konsiderohej si një objekt i luajtshme sipas nenit sipas nenit 9 i Ligjit të Pronësisë dhe të Drejtave tjera Sendore (Ligji nr. 03/L-154). Ndërkaq sipas paragrafit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KPCC nuk kishte kompetenca për të vendosur vetëm për pronat e luajtshme.
9. Më 20 gusht 2013, vendimi iu dorëzua M.M dhe i njëjti ushtroi ankesë në Gjykatë Supreme me 23 gusht 2013 (në tekstin e mëtejme: pala ankuese).
10. Ankuesi shpjegoi që vendimi ankimor nuk është formuluar qartë dhe nuk përmban shpjegim e bazës ligjore dhe faktike të tij. Ai nuk është kontaktuar nga Sekretariati i AKP-ës. Nuk ka prova që paraqitësi i kërkesës e ka tjetërsuar këtë pronë , si dhe kur dhe kujt ia ka tjetërsuar të njëjtën, ashtu siç ka vendosur ky Sekretariat.
11. Prandaj, vendimi i organit i KPCC bazohet me vërtetim jo të plotë të fakteve dhe vlerësim të gabuar të tyre. Po kështu, vendimi ankimor është përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që ta rishikojë vendimin dhe t'i pranoj të drejtat e palës ankuese për kthim dhe shfrytëzimin e pronës si pronar i ligjshëm i sajë.

a. Arsyetimi ligjor:

12. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).
13. Pas shqyrtimit të shkresave të lendes, pretendimeve ankimore, sipas dispozitave të nenit 194 të LPK-ës, Gjykata Supreme gjeti se: ankesa është e pabazuar
14. KKKPK-ja ka bërë vlerësimin e saktë të dëshmive kur ka vendosur që kërkesa nuk është brenda fushëveprimit të saj .KKPK ka dhënë shpjegime dhe sqarime të drejta

të plota, të kuptueshme, të qarta , të sakta dhe rrjedhimisht të ligjshme për faktet vendimtare për një vendim të drejtë.

15. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka ta drejtë nga Komisioni në urdhër për kthim në posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon të drejtën pronësore, ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojnë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershor 1999. Nga kjo dispozitë ligjore rezulton se, juridiksioni i Komisionit për kërkesa pronësore i AKP-ës dhe rrjedhimisht të Gjykatës Supreme është i kufizuar ekskluzivisht për zgjidhjen , gjykimin dhe vendosjen e kërkesave të së drejtës së pronësisë për pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën e paluajtshme bujqësore dhe komerciale.
16. Nuk është kontestuese se sipas aktgjykimin në bazë të pohimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj C.nr.224/90 i dt.17 maj 1990 , S.M i është pranuar e drejta e pronës i pjesës perëndimore i barakës të tipit montazh që gjendet në rrugën e "Njegoshit "nr.14 në Ferizaj, në sipërfaqe prej 8 m².
17. Prandaj, nga kjo gjendje konstatimeve faktike Gjykata Supreme vlerëson se, i drejtë dhe i ligjshëm është vendimi ankimor i Komisionit për Kërkesa Pronësore kur ka vendosur që të hedhet i palejueshme kërkesa e palës ankuese për mungesë të kompetencës ,për shkak se sipas këtij aktgjykimi prona që është objekt i kërkesës është i tipit barakë – montazh që trajtohet si send i luajtshëm.
18. Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se, prona e kërkuar sipas dispozitës së nenit 9 par1 të Ligjit për Pronësi dhe Drejtat tjera Sendore, trajtohet send i luajtshëm. Sipas kësaj dispozite ligjore rezulton se ndërtesat e përkohshme të ndërtuar në tokën ndërtimore të dhënë përkohësisht në shfrytëzim , siç është rasti konkret nuk konsiderohen sende të paluajtshme. Për më tepër sipas nenit 14 par.1 dhe nenit 26 par.2 të Ligjit për Tokën Ndërtimore Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 14/80 parashikon kur organi kompetent e jep në shfrytëzim të përkohshëm për nevojat e përkohshme kërkuarve për vendosjen objekteve të përkohshme i tipit montazh, atëherë ai organi ka të drejtë që sipas nevojave të planit urbanistik ta dislokojë atë objekt me shpenzimet personale të shfrytëzuesit. Madje, objekti i përkohshëm nuk mund të jetë çështje e pranimit të drejtës së pronës e as që mund të regjistrohet në regjistrin e pronësisë së zyrës për kadastër.

19. Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të Gjykatës Supreme ishin pretendimet ankimore të ankuesit se ,vendimi ankimor nuk është formuluar qartë dhe nuk përmban shpjegim e bazës ligjore dhe faktike të tij, se nuk ka prova që paraqitësi i kërkesës e ka tjetërsuar këtë pronë , ashtu siç ka vendosur Sekretariati i AKP-ës, por gjeti se këto pretendime ishin të pabazuara të papranueshme dhe rrjedhimisht të kundërligjshme .Kjo pikërisht për arsye se, vendimi ankimor është formuluar qartë dhe përmban shpjegime të qarta, të plota ,të kuptueshme të bazës ligjore dhe faktike të tij, për aq sa është e nevojshme për një vendim të natyrës procedurale- vendimarrjes për shkak të mungesës së juridiksionit.
20. Me vendimin ankimor nuk është vendosur për meritat e kërkesës sa i përket tjetërsimit apo mos tjetërsimit të pronës së pretenduar, madje Sekretariati ekzekutiv i AKP-ës jo vetëm që nuk ka vendosur për kërkesën e ankuesit lidhur me pronën komerciale të pretenduar ,por ai madje as që është kompetent.
21. Gjykata Supreme i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjtat nuk janë me ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike. Madje, ai as që ka paraqitur dëshmi juridikisht të vlefshme për t'i mbështetur ato pretendime.
22. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen , vendimi ankimor nuk përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtë materiale dhe procedurale .Po kështu ky vendim nuk bazohet në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ,siç pretendon ankuesi.
23. Ky aktgjykim nuk përjashton dhe kufizon të drejtën e paraqitësi të kërkesës për t'i kërkuar të drejtat e tij në gjykatat kompetente.
24. Rrjedhimisht mbi të më sipërmen e me aplikim të ligjit (neni 13.3.C i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

25. Këshillë ligjore:

26. Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

1. *Willem Brower, Kryetare e Kolegjit, EULEX* 3. *Sylejman Nuredini, Gjyqtar*

2. *Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it* *Urs Nufer, Referent i EULEX-it*